



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 71, Datë 27.07.2009

MBI SHQYRTIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV TË SHOQËRISË SË
SIGURIMIT SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SHA

Në bazë dhe për zbatim nenit 124, pika 1 dhe neni 8 të Kodit të Procedurave Administrative”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare pasi mori në shqyrtim të gjitha objeksionet e ngritura nga shoqëria e sigurimit “SIGAL” sh.a, me propozim të Departamentit të Çështjeve Ligjore,

KONSTATOI SE:

Shoqëria “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” sh.a, ka paraqitur ankim ndaj vendimit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare me nr. 58, datë 25.06.2009.

Vendimi i Bordit e sanksionoi shoqërinë me gjobë dhe masa të tjera për shkelje të dispozitave ligjore për sigurimin dhe të Rregullores “Për regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorrik”, miratuar me vendim Bordi nr.3, datë 03.10.2007 (ndryshuar) pasi Shoqëria nuk raportoi shitjen e policave të sigurimit të detyrueshëm motorrik në kohë reale, nëpërmjet regjistrit elektronik të sigurimeve të detyrueshme motorrike, të instaluar në serverat e Autoritetit dhe nuk njoftoi menjëherë Autoritetin për t’i dhënë alternativë tjetër raportimi.

Në ankimin e paraqitur shoqëria bën me dije se ka marrë të gjitha masat, brenda dy ditëve, për zbatimin e vendimit të Bordit dhe riparimin e serverit (duke blerë server të ri) duke plotësuar kushtet për funksionimin normal të sistemit të shitjeve dhe detyrimin ligjor për raportim në kohë reale duke evidentuar të gjitha policat e shitura të pa raportuara.

Për sa më sipër, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare pasi rishqyrtoi rrethanat dhe kushtet konkrete të krijuara pas zbatimit nga Shoqëria të vendimit të Bordit nr. 58, datë 25.06.2009, në bazë të nenit 146/c të Kodit të Procedurës Administrative

V E N D O S I:

1. Ndryshimin e vendimit të Bordit të AMF nr.58, datë 25.06.2009 “Për marrjen e masave administrative ndaj shoqërisë së sigurimit “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SH.A, duke hequr pikën 1 të këtij vendimi.

2. Ngarkohen Departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit.

KRYETAR
Elisabeta GJONI